

KRONIKË

Dy të plagosurit në Lagjen e Spitalit mbasin në mjekim intensiv

Motivi i konfliktit në Lagjen e Spitalit në Prishtinë dyshohet se ka qenë pro...



^ 9 perditese

09:20

Dy të plagosurit në Lagjen e Spitalit mbasin në mjekim intensiv

21:58

Dy të plagosurit vazhdojnë të jenë në gjendje të rëndë, thotë Bajgora

19:08

Vdes edhe i plagosuri i dytë nga konflikti në Lagjen e Spitalit

19:05

Motivi i konfliktit në Lagjen e Spitalit në Prishtinë dyshohet se ka qenë prona

18:16

Mjeku kujdestar konfirmon vdekjen e njërit nga të plagosurit, tre të tjerët në gjendje të rëndë

17:27

Dy të arrestuar për rastin në Lagjen e Spitalit

17:13

Ahmeti njofton se për ngjarjen në Lagjen e Spitalit ka të arrestuar

16:16

Një i vrarë e tre të plagosur rëndë në Lagjen e Spitalit, konfirmon QKUK-ja

16:14

Policia njofton për katër të plagosur në Lagjen e Spitalit

15:58

Të shtëna me armë në Prishtinë, dyshohet për viktima

When Renovating His Home He Stumbles Upon Secrets Within His Own Walls

Habit Tribe | Sponsored

Read Next Story >

“Janë në mjekimin intensiv qendror në gjendje të rëndë, nën përkujdesje intensive të stafit shëndetësor”, ka thënë Fazliu.



21:58

Dy të plagosurit vazhdojnë të jenë në gjendje të rëndë, thotë Bajgora

Mjeku kujdestar në QKUK, Avdush Bajgora, ka folur rreth gjendjes aktuale shëndetësore të dy personave të plagosur, të cilët janë duke u trajtuar në QKUK.

Bajgora, specialist reanimator, tha se pacientët i janë nënshtruar operacioneve kirurgjikale, por gjendja e tyre është e rëndë.

"Ne e kemi marrë në dorë gjendjen e përgjithshme të pacientëve, të cilët momentalisht janë të shtrirë në QKUK. Pacientët i janë nënshtruar operacioneve kirurgjikale, njëri prej tyre ka pasur lëndime në kokë me armë zjarri është intervenuar, gjendja e tij është e rëndë. Dhe tjetri ka pasur lëndime në ekstremitete, ku janë atakuar disa arterie dhe vena me rëndësi vitale. Tek këto raste gjendja është shumë e rëndë dhe momentalisht janë duke u trajtuar në mjekimin intensiv", tha Bajgora për KosovaPress.

Ndërkaq prokurori i rastit Ilaz Beqiri në një përgjigje për KosovaPress ka thënë se dyshohet se tre persona janë përfshirë në të shtënat me armë zjarri në "Mati 1", sot në Prishtinë.

"Dy persona janë arrestuar më herët, ndërsa edhe një person i cili ka qenë i plagosur dhe ndodhet në Klinikën Emergjente, dyshohet se ka kryer vepër penale, mund të konsiderohet i arrestuar", ka thënë Beqiri.

Më herët Bajram Krasniqi, zyrtar për media në Policinë e Kosovës, ka konfirmuar për KosovaPress se gjatë të shtënave me armë zjarri sot në lagjen "Mati 1", një zyrtar policor ka intervenuar në arrestimin e njërit nga të dyshuarit që ka gjuajtur me armë.

Sipas Krasniqit, nuk dihet nëse i njëjti ka gjuajtur edhe me armë.

"Ka qenë kalimtar rasti, jashtë detyrës. Si kalimtar rasti ka hasur në ngjarje dhe ka intervenuar dhe njëri nga të dyshuarit, i cili ka përdorur armën e shkurtër, është arrestuar nga polici, i cili ka qenë kalimtar rasti. Nuk dihet ende nëse i njëjti ka përdorur armën", ka thënë Krasniqi.



19:08

Vdes edhe i plagosuri i dytë nga konflikti në Lagjen e Spitalit

Edhe personi i dytë M.R, i plagosur sot në Lagjen e Spitalit, ka vdekur.

Këtë e ka konfirmuar për gazetën "Koha Ditore", zyra për informim e QKUK-së.

"Po, ka vdekur edhe personi i dytë, i cili përkundër përpjekjeve të mjekeve, për shkak të gjendjes së rëndë nuk ka arritur të mbijetojë", thuhet në përgjigjen e tyre.

When Renovating His Home He Stumbles Upon Secrets Within His Own Walls

Habit Tribe | Sponsored

Read Next Story >

dysnonet se ka qene prona

Një person është vrarë dhe tre të tjerë janë plagosur rëndë në një konflikt me të shtëna me armë zjarri, në Lagjen e Spitalit në Prishtinë.

Televizioni mëson se konflikti ka ndodhur në mes të familjeve fqinje, Mehmeti dhe Rafuna.

Shkak i konfliktit të armatosur dyshohet së janë mosmarrëveshjet pronësore mes tyre, raporton KTV.

Sipas burimeve të Kohës, viktima është B.Mehmeti, ndërsa të plagosurit janë familjarë, G. Rafuna (1943), babai dhe dy djemtë e tij, M. Rafuna (1972) dhe F. Rafuna (1968).

Lidhur me rastin, Policia ka arrestuar dy persona, identitetin e të cilëve nuk e ka bërë të ditur.

Zëdhënësi Krasniqi, ka treguar se në konflikt, janë përdorur armë të shkurta dhe të gjata.

Pasi fillimisht kishte keqinformuar publikun, duke thënë se nuk ka asnjë viktimë, edhe pse diçka e tillë ishte konfirm ^ 9 perditetime ra Klinike Universitare e Kosovës, mjeku kujdestar, Agron Çitaku, më vonë ka konfirmuar vdekjen e një personi.

Ndërsa, ka shtuar se njëri nga tre të plagosurit është në gjendje më të rëndë.

Ndërsa prokurori i rastit, Ilaz Beqiri, nuk ka dhënë detaje lidhur me rastin, duke thënë se Prokuroria do të dalë me një komunikatë, pasi të ketë informacione të mjaftueshme.

Raporti: Fatlum Jashari



18:16

Mjeku kujdestar konfirmon vdekjen e njërit nga të plagosurit, tre të tjerët në gjendje të rëndë

Mjeku kujdestar në Klinikën Emergjente në QKUK, Agron Çitaku, ka thënë se njëri nga të plagosurit në Lagjen e Spitalit, ka vdekur si pasojë e plagëve të marra.

Ai tutje ka shtuar se tre të plagosurit tjerë janë në gjendje të rëndë shëndetësore derisa njëri nga ta është në sallën e operacionit, transmeton Koha.net.

“Njëri nga të plagosurit nuk i ka mbijetuar plagëve të marra, ndërkaq tre të tjerët janë në gjendje të rëndë, një është në sallë të operacionit. Janë të lënduar në pjesë të ndryshme të trupit”, ka thënë ai.

KOHA.net Një i vrarë e tre të plagosur rëndë në Lagjen e Spitalit, ko

When Renovating His Home He Stumbles Upon Secrets Within His Own Walls

Habit Tribe | Sponsored

Read Next Story >

17:27 Dy të arrestuar për rastin në Lagjen e Spitalit

Policia e Kosovës ka konfirmuar se lidhur me rastin që ka ndodhur pasditen e së enjtes në Lagjen e Spitalit, janë arrestuar dy persona.

Zëdhënësi Bajram Krasniqi nuk ka pranuar të flasë për arsyet e ngjarjes, ndërsa për të dy familjet që dyshohet se ishin pjesë e konfliktit ka thënë se kanë jetuar afër vendit të ngjarjes.



17:13 Ahmeti njofton se për ngjarjen në Lagjen e Spitalit ka të arrestuar

Kreu i Prishtinës, Shpend Ahmeti, duke shprehur ngushëllime për humbjen e jetës së një personi dhe keqardhjen për plagosjen e tre të tjerëve, ka njoftuar gjithashtu se Policia e Kosovës ka arrestuar disa persona.

“Me shqetësim pranuar lajmin për ngjarjen e rëndë në Prishtinë ku si pasojë e një përleshjeje ka humbur jetën një qytetar dhe tre të tjerë janë të plagosur rëndë. Ekipet e Policisë dhe Mjekësisë Urgjente kanë reaguar menjëherë dhe prioritet është trajtimi i të plagosurve të cilët tashmë janë transferuar në QKUK. Policia është duke mbledh informatat dhe tashmë ka edhe të arrestuar, por të gjitha informatat e sakta do të bëhen të ditura pas hetimeve nga institucionet e rendit”, ka thënë Ahmeti.

“Në emër të Komunës shpreh ngushëllime për familjen e viktimës, e lutemi e shpresojmë se të lënduarit e tjerë të shërohen”, ka shtuar më tej ai.



16:16 Një i vrarë e tre të plagosur rëndë në Lagjen e Spitalit, konfirmon QKUK-ja

Njëri nga katër personat e dërguar në QKUK ka vdekur.

Një gjë të tillë për ‘Kohën Ditore’ e ka konfirmuar Basri Sejdiu drejtor i ShSKUK.

Sipas tij, gjendja e tre të plagosurve të tjerë është e rëndë. Koha Ditore mëson se personi që ka vdekur është B.M, ndërkaq të plagosurit janë M.R 1972, G.R 1943 dhe F.R 1968.

Dëshmitarët kanë thënë se konflikti ka ndodhur mes pronarëve të tokave në të cilat është ndërtuar një kompleks banesor. Dëshmitarët po ashtu i kanë thënë KTV-së se një nga personat që ka shtënë, është polic.

When Renovating His Home He Stumbles Upon Secrets Within His Own Walls

Habit Tribe | Sponsored

[Read Next Story >](#)



KOHA.net Një i vrarë e tre të plagosur rëndë në Lagjen e Spitalit, konfirm



^ 9 perditese



16:14

Policia njofton për katër të plagosur në Lagjen e Spitalit

Policia e Kosovës ka njoftuar se nga të shtënat me armë në pasditen e së enjtes në Lagjen e Spitalit në Prishtinë, katër persona janë plagosur.

Zëdhënësja e Policisë së Kosovës për rajonin e Prishtinës, Flora Ahmeti, ka thënë se të plagosurit janë dërguar për tretman mjekësor.

“Sot rreth orës 16:00, kemi pranuar informatën për të shtëna me armë në rrugën Muharrem Fejza në Prishtinë. Menjëherë në vendin e ngjarjes kanë dalë njësitet policore të cilat kanë hasë në katër persona të plagosur, te njëjtit janë dërguar për tretman mjekësor. Për çdo detaj rreth rastit do te njoftoheni me kohe”, ka thënë ajo për KTV-në.



15:58

Të shtëna me armë në Prishtinë, dyshohet për viktima

Të shtëna me armë janë dëgjuar pasditen e së enjtes në Prishtinë, në Lagjen e Spitalit.

Dyshohet për disa viktima.

Policia ende nuk ka arritur të konfirmojë rastin.

KOHA.net Të shtëna me armë në Prishtinë, dyshohet për viktima

When Renovating His Home He Stumbles Upon Secrets Within His Own Walls
Habit Tribe | Sponsored

[Read Next Story >](#)